

KONTRATE DHURIMI KUOTASH

Sot më datë 28/01/2022 bazuar në nenin 73 pika 1/b të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" – i ndryshuar dhe nenin 705 e vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", nënshkruhet kjo kontratë për dhurimin e kuotave të Shoqërisë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k, me Nipt L81806005A.



Dhuruese:

1. **Znj. Pamela Salija**, atësia Bledar, lindur më 15.09.1991, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridikë për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr.Personal J15915063E, zotëruese e 100 % të kuotës në kapitalin themeltar të Shoqërisë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k, me Nipt-L81806005A;

(referuar si "Dhuruese");

dhe

Pranues i Dhurimit:

1. **Z. Mariglen Protoduari**, atësia Flori, lindur më 02.03.1992, në Skrapar dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridikë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr.Personal J20302075E.

(referuar si "Pranues i Dhurimit");

Të Përgjithshme

- A. **Shoqëria "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr.NIPT-L81806005A, datë 06.06.2018;

- Pamela Salija, zotëruese e 100 % të kuotës në kapitalin themeltar të Shoqërisë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k.

- B. **Z. Mariglen Protoduari**, atësia Flori, lindur më 02.03.1992, në Skrapar dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridikë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr.Personal J20302075E.

Neni 1

Objekti

Dhuruesja, Zj.Pamela Salija, bie dakort të transferoj nëpërmjet dhurimit në total 100 % të kuotës kapitalit themeltar që zotëron në Shoqërinë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k, tek Pranuesi i Dhurimit, Z.Mariglen Protoduari atësia Flori, lindur më 02.03.1992, në Skrapar dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridikë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr.Personal J20302075E.

Neni 2

Gjendja e Kuotave

Kuota, objekt i kësaj kontrate, është plotësisht e disponueshme, e transferueshme, dhe e lirë nga çdo lloj pengu, hipoteke apo barre tjetër ligjore.

Neni 3

Vlera e Dhurimit

Vlera totale e kuotës së dhuruar është ALL 100 000 Lekë (njëqind mijë Lekë).

Neni 4
Deklarimet dhe garancitë

Dhuresja deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate zotëron 100 % të kuotës, që do të transferohet nëpërmjet dhurimit sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'a transferuar këtë kuotë dhe se nënshkrimi apo zbatimimi i kësaj Kontrate nga Dhuresja nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuresja.

Pranuesi i Dhurimit deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ka tagra të plota për të pranuar 100 % të kuotës në total nga Dhuresja, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi i Dhurimit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është transferimi i 100 % të kuotës që Dhuresja zotëron. Pranuesi i dhurimit është mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve menjëherë pas nënshkrimit të këtij akti dhe rregjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Transferimi i pronësisë mbi 100 % të kuotës objekti i kësaj Kontrate kryhet nga Dhuresja tek Pranuesi i Dhurimit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

Neni 5
Transferimi i kuotave

Pas transferimit nëpërmjet dhurimit të pronësisë të 100 % të kuotës sipas kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kuotës të Shoqërisë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k, do të jete si vijon:

- Mariglen Protoduari zotëruar i 100 % të kuotës në kapitalin e Shoqërisë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k.

Neni 6
Të drejtat dhe detyrimet

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i dhurimit gëzon të gjitha të drejtat për të rregjistruar pronësinë mbi kuotën përfituar nga dhurimi nëpërmjet kësaj kontrate, në Shoqërinë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7
Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim nga të dy palët në rast të kundërt do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8
Gjuha e Kontrates dhe Hyrja ne Fuqi

Kjo kontratë hartohet në 3 ekzemplare, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës. Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

PALET

Dhuresja

Znj. Pamela Salija



Pranues i Dhurimit

Z. Mariglen Protoduari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ARDJANA A. MEDIU



V2022050620040124330

DATE 28/01/2022
NR REP 544

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 28.01.2022, para meje Notere ARDJANA A. MEDIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tirane, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqitën personalisht:

DEKLARUESIT:

Zj.Pamela Salija, atësia Bledar, amësia Donika, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë: "Lagjja Nr 13", Rr: "Eduart Mano"; Nd. 38; H. 1; Ap. 6; Farkë; Selitë; 1045; lindur më 15/09/1991, gjendja civile e martuar, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 035759286 dhe Nr. Personal J15915063E.

dhe

Z.Mariglen Protoduari, atësia Flori, amësia Lindita, shtetas shqiptar, lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Teodor Keko"; Nd. 275; Njësia Administrative Nr. 6; 1027; lindur më 02/03/1992, gjendja civile beqar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 037183645 dhe Nr. Personal J20302075E.

Të cilët në vullnet të lirë dhe të plotë u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Kontratë Dhurii Kuotash datë 28.01.2022", bashkëlidhur.

Unë Noterija, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Naterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
ARDJANA A. MEDIU

REZULTATET E KËRKIMIT



Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-2022012883741749
Data e Rezultatit te Kerkimit: 28.01.2022
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 8:37:41AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-005-742
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

PAMELA BLENDAR SALIJA
CONCEPT ALBANIA SH.P.K.



Florida Dedaj

Shoqëria "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k"
NIPT -L81806005A
Adresa: Kashar, Zona Kadastrale 2105, Tiranë
Mbikallimi i Ri Rinas



VENDIM Nr. 1, datë 9/01/2022

(i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k)

Sot më datë 9/01/2022, në selinë e shoqërisë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k", me NIPT-L81806005A, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, datë 06.06.2018, u mbledh Asambleja e Ortakut të Vetëm me prezencë të 100% të kuotës në kapitalin themelitar të shoqërisë të zotëruara nga:

Zj.Pamela Sallja, atësia Bledar, lindur më 15.09.1991, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridikë për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr.Personal J15915063E.

RENDI I DITES

Asambleja e Ortakut të Vetëm me prezencë të 100% të kuotës në kapitalin themelitar të Shoqërisë, në përputhje me Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe duke zbatuar me përpikmëri Statutin e Shoqërisë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k, deklaroi të thirrur këtë mbledhje për të diskutuar dhe vendosur sa më poshtë:

1. Diskutimin për transferimin nëpërmjet dhurimit, të 100 % të kuotës që Dhuruesja, Zj.Pamela Sallja, zotëron në Shoqërinë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k tek Pranuesi i Dhurimit, Z.Mariglen Potoduari, atësia Flori, lindur më 02.03.1992, në Skrapar dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr.Personal J20302075E.

Asambleja e Ortakut të Vetëm në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" – i ndryshuar dhe duke zbatuar me përpikmëri Statutin e Shoqërisë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k, në unanimitet:

VENDOSI

1. Miratimin për transferimin nëpërmjet dhurimit, të 100% të kuotës që Dhuruesja, Zj.Pamela Sallja, zotëron në Shoqërinë "CONCEPT ALBANIA" Sh.p.k tek Pranuesi i Dhurimit, Z.Mariglen Potoduari, atësia Flori, lindur më 02.03.1992, në Skrapar dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr.Personal J20302075E.

ORTAKU I VETËM

Pamela Sallja